



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË  
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY  
DVSM

# *TESTI I MATURËS*

**GJIMNAZI  
SHKENCA NATYRORE**



Prishtinë, qershor 2008

Emri dhe mbiemri i nxënësit .....


Shkolla.....

### Udhëzime:

**Koha:** Keni 180 minuta që t'ju përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'ju zgjidhni kërkesat.

### Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'ju përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

**Lexo fragmentin e mëposhtëm, të përbërë nga dy paragrafë, dhe përgjigju pyetjeve nga 1 deri në 15.**

**I.**

Dola jashtë qytetit, përtej Urës së Bahçallekut. Fillova me recitue: “*Përmbi lumë të Babilonit, atje ndejem dhe lotueme, kah na shkonte malli i Sionit*”. Ecëshem i vetmuem. U mendojshem me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë. Por nata mue më kishte xanë, nata e mendjes. Un nuk dijshe ma se kah me ia mbajtë. Ku jam? Ku shkoj? Aty? Atje? Ku? Ç’ do të baj?

E ndjeva vedin se nuk ishem kurrëgjja tjetër por një tullumbac në hava që sillet në atë drejtim që ta çojë era. E shka asht era? A thue asht vetë jeta? Trishtim i madh!

O zot, rri me ne se asht kah erret!

**II.**

E kupton? Ti ke ardhë këtu në kohën ma t’keqe që ka pas Katolicizmi ndonjiherë e sidomos na. Ktheu në katund, aty ku ishe, struku, mos fol, as mos i beso as këmishës sate. Na kemi nevojë për ty që të jetojsh e jo me dekë. Na pleqtë edhe në ardhhtë puna me dekë, e kemi kositë livadhin, por ju të rijt duhet të jetoni. Zoti asht i Madh. I kjosim fal atij të lumit që ka krijue vdekjen, se për ndryshej njerzit do t’kishin me kenë skllav të tiranve. Edhe kta do t’desin një ditë, e ti duhesh t’jetojsh vetëm sa me tregue. Kurrëgjja në mos kjosim i zoti me ba rrno vetëm për me tregue. A e kupton shka po du me t’thanë? Mbaruen të tjerët, mbarojmë na, mbaron edhe ti: të gjithë shkojnë si qeni në rrush po nuk kje dikush me kallxue si kje puna. Kush te teproj le të kallxojë! Nuk asht fjala që po mbarojmë sot. E dijmë këtë. Nuk duhet të mbarojmë për nesër e për shekujt e ardhshëm. E kupton këtë? Fra Zef un jam sot për sot Superjor: po ta jap urdhër: Ik rrno! Vetëm për me tregue!

**At Zef Pllumi**  
*(Rrno vetëm për me tregue)*

**1. Paragrafi i parë i tekstit është:**

- A. ese;
- B. reportazh;
- C. prozë poetike;
- D. fragment drame.

**2. Togfjalëshi: „e kemi kositë livadhin”, në paragrafin e dytë, e ka kuptimin:**

- A. kemi punuar shumë deri tash;
- B. duhet të pushojmë tash e tutje;
- C. gjithë jetën kemi punuar kot së koti ;
- D. e kemi jetuar pjesën më të madhe të jetës.

3. Në paragrafin e parë, **informacioni themelor** nga del motoja: „*O zot, rri me ne se asht kah erret!*” është:

- A. U mendojshem me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë;
- B. Por nata mue më kishte xanë, nata e mendjes. Un nuk dijshe ma se kah me ia mbajtë;
- C. E ndjeva vedin se nuk ishem kurrnga tjetër por një tullumbac në hava që sillet në atë drejtim që ta çojë era;
- D. Dola jashtë qytetit, përtej Urës së Bahçallekut.

4. Në paragrafin e dytë, fjalia: „... *mos fol, as mos i beso as këmishës sate*” **shpreh**:

- A. mosbesim;
- B. inferioritet;
- C. epërsi;
- D. miqësi.

5. Fjalia, te paragrafi i dytë: „*Kush të teproj le të kallxojë!*”, ka kuptimin:

- A. kush e tepron duhet të tregojë;
- B. kushdo që mbetet gjallë le të tregojë;
- C. kush tregon do te shpëtojë;
- D. kush nuk shpëton s’ka çka tregon.

6. Në paragrafin e parë, fjalia: „*Un nuk dijshe ma se kah me ia mbajtë*” **mbështetet** në:

- A. gjendjen personale – psikologjike;
- B. të dhënat historike- kombëtare;
- C. gjendjen sociale-politike;
- D. analizën gazetareske të gjendjes.

7. Në paragrafin e dytë, fjalia: „*I qofshim fal atij të lumit që ka krijue vdekjen*” **në shqipen standarde** bën:

- A. I qofshim falë atij të lumit që ka krijue vdekjen;
- B. I qofshim fal atij të lumit që ka kriju vdekjen;
- C. I qofshim fal atij të lumit që ka krijua vdekjen;
- D. I qofshim falë atij të lumit që ka krijuar vdekjen.

8. **Titulli më i përshtatshëm** për paragrafin e parë do të ishte:

- A. Fillova me recitue;
- B. Mbi lumë të Babilonit;
- C. Nata e mendjes;
- D. Kah me ia mbajtë.

9. **Gjuha e përdorur** në të dy paragrafët është:

- A. letrare;
- B. gegërishte,
- C. toskërishte;
- D. çamërishte.

**10.** Cili **diskurs** mbizotëron në paragrafin e parë?

- A. historik;
- B. heroik;
- C. personal;
- D. jopersonal.

**11.** Fjala: „*ecëshem*” në fjalinë „*Ecëshem i vetmuem*”, të paragrafit të parë, në **shqipen standarde** bën:

- A. ecja;
- B. ecëshim;
- C. ecnim;
- D. ecsha.

**12.** Tema **qendrore** e këtij teksti ka të bëjë me:

- A. artin;
- B. letërsinë;
- C. kulturën;
- D. ideologjinë.

**13.** Në fund të fjalisë: „*Jeto vetëm për të treguar*” , **duhet të vihet:**

- A. pikëpresja;
- B. pikëpyetja;
- C. pikë çuditësja;
- D. dy pikat.

**14.** Folja *jetoj* në mënyrën **dëshirore**, koha e tashme, veta e tretë njëjës, në formën veprorë bën:

- A. jetoj;
- B. jetuakam;
- C. jetofsha;
- D. jetoftë.

**15.** Periudha: „*I kjoshim fal atij të lumit që ka krijue vdekjen, se për ndryshej njerzit do t’kishin me kenë skllav të tiranve*” në paragrafin e dytë është:

- A. e bashkërenditur;
- B. e nënrenditur;
- C. pyetëse;
- D. habitore;

**Lexo poezinë e mëposhtme pastaj përgjigju pyetjeve nga 16 deri në 19.**

**KUSH JE TI?**

Kush je ti? Sfidë e shekujve,  
grusht i tiranëve, tmerr i mbretërve.  
Lirinë kërkon. Pushka s'ka çark.  
Fluturimin do e krahët s'i hap.  
Me raso je veshur, zotin tall.  
Kush je ti? Perëndi a djall?

Herë Bethoven, herë Kajam.  
Nuk e di kur qesh, nuk e di kur qan.  
Ofeli e ëmbël, korb qe te tremb,  
të dhemb kaq shumë e s'di ç'të dhemb.  
Hamlet i ngrysur, Sanço hokatar,  
gjysmë asket, gjysmë mëkatar.

Herë urrejtje, herë dashuri.  
Kush je ti? Zjarr apo hi?  
Zhurmën e pëlqen, heshtjes i flet,  
gjysma lolo, gjysma mbret.  
Këmbët në Boston, zemrën në Ballkan.  
Njëri sy të qesh, tjetri sy të qan.

Duart të ngrijnë, zjarrin s'e ndez.  
Lumenjtë i pi e etja të djeg.  
Heshtje e shurdhër, gjëmim hata.  
Kush je ti, kush je ti, pra?  
Oh, po pas dilemës u fshehka gjeniu,  
brenda një loti ndritka njeriu.

Kështu ngjitesh e zbret shekujve;  
sfidë e harrimit, tmerr i mbretërve,  
zjarr që përvëlon, kallkan acar.  
Kush je ti? NOLI shqiptar!

**(Bardhyl Londo)**

**16. Forma e kësaj poezie është:**

- A. sonet;
- B. varg i matur;
- C. akrostik;
- D. varg i lirë.

**17. Në vargun: *kështu ngjitesh e zbret shekujve*  
*Sfidë e harrimit tmerr i mbretërve,***

**mbizotëron:**

- A. asonanca;
- B. simploka;
- C. aliteracioni;
- D. anadiploza.

**18.** Forma e **shkrimit të figurshëm** si në fjalinë: „*Ofeli e ëmbël, korb që të tremb*”, është **tipike** për:

- A. tekste letrare;
- B. fjalime politike;
- C. tekste gazetareske;
- D. dokumente zyrtare.

**19.** Vargu: „ *gjysma lolo, gjysma mbret*” **interpretohet** si:

- A. lavdërim ndaj prijësve;
- B. respekt ndaj revolucionarëve;
- C. përqeshje ndaj qeveritarëve;
- D. mitizim i sundimtarëve.

**Lexo tekstin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjeve nga 20 deri në 25.**

**I.**

Fëmijët i porositi ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë, as kur do të vuajnë pa faj. Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret. Këtu kanë lindur, këtu të rrojnë me mish e shpirt, qoftë edhe me dhembje.

**II.**

Profesionizmi në letërsi, në vendin tonë është hë për hë, një rrugë vuajtjesh, buka e tij është e hidhur. E hidhur, them, për atë që s’di marifete dhe hipokrizia. Terreni i letërsisë është një tokë ku gëlojnë gjarpërinjtë. Të vrasin shokët, se u bën hije. Dhe kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti për letërsi.

**III.**

Dorëshkrimet ua lë atyre të dyve, sidomos Pandeliut. Të mos i prek askush! Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e perealizuar, do t’i përpunojë. Për këtë duhet të grumbullojë më parë shumë kulturë. Talenti, prirja nuk vlejnë asgjë pa punë, pa kulturë.

Askush të mos i prek dorëshkrimet para se të më rritet djali! I vini në arkë, i mbyllni!”

**Mitrush Kuteli**  
( **Testamenti, 1965** )

**20.** Fjala **hipokrizi** në fjalinë: „*E hidhur, them, për atë që s’di marifete dhe hipokrizira*” e ka kuptimin e:

- A. smirës dhe inatit ;
- B. lojës dhe humorit;
- C. misterit dhe prapavijës;
- D. mashtrimit dhe dyfytërisë.

**21.** Cila fjali paraqet **informatë themelore** në këtë tekst?

- A. Profesionalizmi në letërsi, në vendin tonë është një rrugë vuajtjesh;
- B. Askush të mos i prek dorëshkrimet para se të më rritet djali;
- C. Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e perealizuar, do t’i përpunojë;
- D. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë, as kur do të vuajnë pa faj.

22. Fjala: „Ay”, në fjalinë „Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e perealizuar, do t'i përpunojë” ka kuptimin:

- A. ty;
- B. ai;
- C. aty;
- D. ti.

23. Fjalët: „vrrarë, gëlojnë, rritet”, në gramatikë janë:

- A. folje;
- B. ndajfolje;
- C. emra;
- D. mbiemra.

24. Shenja e pikësimit ! në fund të fjalisë: „ I vini në arkë, i mbyllni!” është:

- A. apostrof;
- B. pikëpyetje;
- C. pikëpresje;
- D. pikë çuditëse.

25. Testamenti është **rrëfim intim** për:

- A. shokët dhe porosi për miqtë e tij;
- B. lexuesit dhe porosi për masat e gjera;
- C. familjarët dhe porosi për fëmijët;
- D. prindërit dhe porosi për të parët e tij.

## ENGLISH LANGUAGE

26. Choose the correct alternative to complete the following sentence:

**That night the ground started to shake exactly at 12 p.m. It started to shake \_\_\_\_\_.**

- A. in the middle of the night.
- B. at midnight.
- C. during the night.
- D. after midnight.

27. Read the following sentences:

1. The story is about a remote village in the middle of nowhere.
2. But one day he disappears with no trace and everything goes wrong.
3. Everybody is happy until a stranger comes to village to sick his fortune.
4. It is the most exciting book I have ever read.
5. He makes a plan to build a large factory and employ many villagers.

**The correct order of sentences to form a dialogue is:**

- A. 1 2 3 4 5
- B. 3 2 1 5 4
- C. 4 1 3 5 2
- D. 4 5 2 1 2



28. You are going to travel long distance and are considering the most convenient means of transport. Look at the table below and choose the correct answer:

Means of transport	advantages	Disadvantages
Car	Takes you wherever you want to go, cheap,	Traffic jams, not safe, cannot read, sleep, cannot watch the world go by
Train	No traffic jams, fast, comfortable, can read, watch the world go by	Expensive, crowded, cannot take you door to door
Bus	Cheap, can read, sleep, watch the world go by	Not very comfortable, blocked roads, speed limit, cannot walk or stand
Ship	Comfortable, luxurious, cheap, can socialize, relax, make the most of it	Takes too long, makes you seasick, dangerous if you can't swim
Airplane	Fast, comfortable, can read, sleep, eat	Very expensive, dangerous, need a taxi or bus to airport

- A. One cannot sleep or read or see the world go by while travelling by bus.
- B. Travelling by airplane you can see the world around you all the time.
- C. Train takes you wherever you want to go and stops at the point you want.
- D. As far as safety conditions are concerned cars are as dangerous as airplanes.

29. Choose a word to complete the following sentence:

'This is indeed a very nice room' 'Yes, but I must \_\_\_\_\_ it by the end of this month.'

- A. vacate
- B. abandon
- C. leave
- D. evacuate

30. Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:

Barbara: I wanted to tell you the truth but you wouldn't listen.

Shirley: \_\_\_\_\_. I know the whole story.

- A. It's no bother!
- B. Don't trouble!
- C. Don't bother!
- D. It's no trouble!

**31.** In the following dialogue:

**George: Did you buy that house?**

**Steven: I didn't. I couldn't get \_\_\_\_\_ .**

from the following expressions:

1. pocket money
2. mortgage
3. allowance
4. grant

Steven should say, '**the mortgage**' because \_\_\_\_\_.

- A. this is the money he should have in the house when he buys it.
- B. this is the money he borrows when he buys a house and has to pay back.
- C. this is the money he should have in his pocket when he buys a house.
- D. this is the money he borrows when he buys a house and doesn't pay back.

**32.** Choose the correct answer to complete the sentence:

**In the world of animals \_\_\_\_\_ is considered the king.**

- A. lion
- B. a lion
- C. the lion
- D. that lion

**33.** Look at the following nouns. One of these words **DOES NOT** exist. Which one?

- A. solemnity
- B. celebrity
- C. tranquility
- D. accountility

**34. Choose the correct sentence:**

- A. Because I applied for that new job a friend of mine recommended it to me.
- B. I applied because for that new job a friend of mine recommended it to me.
- C. I applied that new job for because a friend of mine recommended it to me.
- D. I applied for that new job because a friend of mine recommended it to me.

**35. Look at the words in the box:**

**people - what - think - think - you - do - these - world - rest - the - the - of - of**

**The correct combination to form a question is:**

- A. What do these people think you of the rest of the world think?
- B. What the rest of the world think do you think of these people?
- C. What do you think these people think of the rest of the world?
- D. What these people do think of the rest of the world think you?

**36. Which word is different?**

- A. bring
- B. swing
- C. cling
- D. wing

37. In the words given below the **underlined letter(s)** is pronounced in the same way **EXCEPT** in one. Which one?

- A. enough
- B. though
- C. though
- D. rough

38. In the string of words: **wet, rain, dry, cloudy, windy** the word **rain** is different because

- A. it is a noun
- B. it's an adjective
- C. it denotes weather conditions
- D. it doesn't denote weather conditions

39. **Read the paragraph carefully:**

Now Scotland needs a goal for a draw. **They need two goals for a win.** Can they do it? MacLeish has got the ball for Scotland. Listen to the crowd! They live the little striker from Glasgow rangers! MacLeish is going past Brown...Brown can't stop him. MacFarlane is on his right, MacPherson is on his left... MacFarlane wants the ball. But MacLeish isn't going to give it to him. The goalkeeper is coming towards him...he's going past the goalkeeper...and that's it. It's there! It's a draw! The referee is blowing his whistle. That's the end of the game!

**Look at the highlighted sentence and complete the following sentence:**

The commentator \_\_\_\_\_.

- A. thinks that that they will win.
- B. calculates the winning score.
- C. is convinced that they will win.
- D. considers that that they should win.

40. **Read the following paragraph:**

Ginger's expenditure is stable. Her monthly course fee is 95€ the bus fare is 24€ the flat rent is not very high; however 320€ is a lot of money for a student. Apart from this she usually spends other 200€ for food. Not counting clothes, books, wireless connection expenses, going out with friends and similar, her monthly expenses are \_\_\_\_\_.


- A. six hundred and ninety-four Euros
- B. five hundred and ninety-four Euros
- C. six hundred and thirty-nine Euros
- D. seven hundred and thirty-nine Euros

## MATEMATIKË

41. Është dhënë figura


Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e figurës?

- A.  $cd + af$
- B.  $ab - ed$
- C.  $bc + fe$
- D.  $ac - ed$



42. Sipas grafikut të funksionit të dhënë në figurë, sa është  $f(0) + f(2)$  ?

- A. 0
- B. 1
- C. 2
- D. 3



43. Laura në ditën e parë të muajit mars shpenzoi 2€ ditën e dytën shpenzoi 4€ ditën e tretë 6€ e kështu me radhë. Cili pohim është i saktë për shumën e parave që shpenzoi Laura nga dita e parë e marsit, deri më 12 mars?

- A. më pak se 138€
- B. ndërmjet 138 € dhe 148€
- C. ndërmjet 148 € dhe 158€
- D. më shumë se 158€

44. Në qoftë se vlen  $x^3 + y^3 = 28$  dhe  $x^2 - xy + y^2 = 7$ , atëherë sa është vlera e  $x + y$  ?


- A. 3
- B. 4
- C. 5
- D. 6

45. Sa është vlera shprehjes numerike komplekse:  $A = (\sqrt{1+i} + \sqrt{1-i})^2$ , ku  $i^2 = -1$  ?

- A.  $A = 0$
- B.  $A = 1$
- C.  $A = 2 - 2\sqrt{2}$
- D.  $A = 2 + 2\sqrt{2}$

46. Cili ekuacion kuadratik i përgjigjet gjetjes së  $x$  sipas të dhënave në figurë ?

- A.  $x^2 + 6x - 55 = 0$
- B.  $x^2 + 6x + 55 = 0$
- C.  $x^2 - 6x - 55 = 0$
- D.  $x^2 - 6x + 55 = 0$



47. Pagesat e punonjësve në një kompani jepen në tabelën e mëposhtme. Sa është paga mesatare në kompani ?

- A. 237 €
- B. 247 €
- C. 257 €
- D. 267 €

Pagesa	Merret prej
210€	2 teknikësh
380 €	1 inxhinieri
240€	6 punëtorësh
430€	1 menaxheri

**48.** Janë paraqitur tri figura të formuara prej trekëndëshave.

Cila formulë i përgjigjet numrit të trekëndëshave (të vegjël) të figurës së  $n$ -së, nëse kështu vazhdohet ndërtimi i tyre?

- A.  $n$
- B.  $n^2$
- C.  $n+1$
- D.  $n^2 + 1$



Figura 1




Figura 2




Figura 3

**49.** Në një shportë ka më pak se 100 mollë. Mollët mund të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet 2, 3 ose 5 fëmijësh, por jo ndërmjet 4 fëmijësh. Sa mollë ka në shportë?

- A. 6
- B. 15
- C. 30
- D. 60

**50.** Me cilën shprehje është ekuivalente shprehja  $(3^{-2} \cdot \sqrt{3})^2$  ?

- A. 27
- B.  $\frac{1}{27}$
- C. 81
- D.  $\frac{1}{81}$


**51.** Në qoftë se  $\log_a 27 = 3$ , atëherë sa është vlera e  $a - 3$  ?

- A. 0
- B. 3
- C. 9
- D. 27

**52.** Është dhënë figura.

Sa është lartësia e shtyllës sipas të dhënave në figurë

- A. 3 m
- B. 3.5 m
- C. 4 m
- D. 4.5 m



**53.** Dy zare (kube për lojë) në faqet e të cilave janë shënuar numrat prej 1 deri 6 hidhen njëkohësisht. Sa është gjasa që të fitohet shuma 7 ?

- A.  $\frac{7}{36}$
- B.  $\frac{7}{12}$
- C.  $\frac{1}{36}$
- D.  $\frac{1}{6}$

54. Sa është vlera e  $\frac{\cos \pi + \log_{10} 10 - 5^0}{3^{-1}}$  ?

- A. 3
- B. -3
- C.  $\frac{1}{3}$
- D.  $-\frac{1}{3}$

55. Sa është vlera e shprehjes:  $\frac{V_3^2 \cdot P(n)}{2!}$  ?

- A.  $n!$
- B.  $n$
- C.  $3n!$
- D.  $3n$

56. Sa është vlera e  $\lim_{x \rightarrow 0} \frac{\sin^2 x}{1 - \cos x}$  ?

- A. 2
- B. -2
- C. 0
- D.  $\infty$

57. Është dhënë vargu aritmetik :  $1, a_2, 9, a_4, a_5, 21, \dots$

Çfarë vlere ka termi  $a_7$  ?

- A. 23
- B. 24
- C. 25
- D. 26

58. Është dhënë ekuacioni:  $(2x - 3y)^2 + 12xy = 36$ .

Çfarë lakore të gradës së dytë paraqet ekuacioni i dhënë ?

- A. rreth
- B. elipsë
- C. parabolë
- D. hiperbolë

59. Është dhënë funksioni  $f(x) = x \cdot \sin x$ . Sa është  $f'(\pi)$ ?

- A. 0
- B.  $\pi$
- C. -1
- D.  $-\pi$

60. Cila është zgjidhja e integralit  $I = \int \frac{x-1}{x^2-1} dx$  ?

- A.  $I = \ln(x+1) + c$
- B.  $I = \ln(x^2+1) + c$
- C.  $I = \frac{1}{2} \ln(x+1) + c$
- D.  $I = 2 \ln(x+1) + c$

## FIZIKË

61. Nëse raporti i periodave të dy lavjerrësve matematikë është  $\frac{T_1}{T_2} = \frac{4}{3}$ , atëherë raporti i gjatësisë të atyre dy lavjerrësve duhet të jetë:

- A.  $\frac{l_1}{l_2} = \frac{3}{4}$
- B.  $\frac{l_1}{l_2} = \frac{4}{3}$
- C.  $\frac{l_1}{l_2} = \frac{9}{16}$
- D.  $\frac{l_1}{l_2} = \frac{16}{9}$


62. Nëse trupat me masa të njëjta vendosen në planetet Tokë, Merkur, Mars dhe Uran, në cilin prej këtyre planeteve trupi ka peshë më të vogël?

- A. Merkur
- B. Tokë
- C. Mars
- D. Uran

63. Një enë e mbushur me rërë ka vrira në fundin e saj. Ena bie vertikalisht poshtë me rënie të lirë, ku mjedisi i lëvizjes është vakum. Çka do të ndodh me rërën në enë?

- A. Rëra do të derdhet sepse ena ka vrira në fundin e saj
- B. Ena bie përpara rërës sepse ka peshë më të madhe
- C. Ena rri pezull, ndërsa rëra bie nëpër vrimat e enës
- D. Rëra nuk do të derdhet nga vrimat e enës sepse është rënie e lirë

64. Në cilën prej këtyre rasteve në figurat e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të rregullt amplituda dhe gjysma e gjatësisë valore të valës?



- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

65. Frekuenca e rrotullimit të trupit është  $\nu = 0,2\text{Hz}$ . Sa rrotullime i kryen trupi. brenda kohës  $t = 60\text{ s}$  ?


- A.  $n = 12$
- B.  $n = 30$
- C.  $n = 60$
- D.  $n = 20$

66. Raporti në mes të shumës së grimcave në bërthamë me masën e bërthamës së heliumit është:

- A.  $\frac{2m_p + 2m_n}{m_{b(He)}} = 1$
- B.  $\frac{2m_p + 2m_n}{m_{b(He)}} < 1$
- C.  $\frac{2m_p + 2m_n}{m_{b(He)}} > 1$
- D.  $\frac{2m_p + 2m_n}{m_{b(He)}} = 0$

67. Në figurë është paraqitur rregulla e parë e Kirkofit. Sa është intensiteti i rrymës elektrike në ampermetër?

- A.  $I = 1\text{ A}$
- B.  $I = 4\text{ A}$
- C.  $I = 3\text{ A}$
- D.  $I = 2\text{ A}$




68. Dy trupa me masa të ndryshme janë të lidhura me një sustë dhe lëvizin me kah të kundërt si në figurë. Sa duhet të jetë masa e panjohur e trupit? (shih.fig.).

- A.  $m = 1,4\text{ Kg}$
- B.  $m = 1,2\text{ Kg}$
- C.  $m = 1,8\text{ Kg}$
- D.  $m = 2,2\text{ Kg}$



69. Në cilin nga rastet në figurë është paraqitur në mënyrë të rregullt kahu i shpejtësisë dhe forcës centrifugale të lëvizja rrethore e trupit?


- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV






70. Në figurë është paraqitur lëvizja e një komete rreth diellit. Çfare vlerash të energjisë kinetike dhe potenciale ka kometa në pikën B?

- A. Energji kinetike minimale, energji potenciale minimale
- B. Energji kinetike maksimale, energji potenciale minimale
- C. Energji kinetike minimale, energji potenciale maksimale
- D. Energji kinetike maksimale, energji potenciale maksimale



71. Në cilën figurë është paraqitur në mënyrë të rregullt transistori i tipit NPN?

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV




72. Induksioni magnetik i përçuesit me rrymë elektrike caktohet me shprehjen:.

- A.  $B = \frac{\mu_0}{2\pi} \cdot \frac{I}{r}$
- B.  $B = \frac{\mu_0}{2} \cdot \frac{I}{r}$
- C.  $B = \frac{\mu_0}{\pi} \cdot \frac{I}{r}$
- D.  $B = \frac{\mu_0}{2\pi} \cdot \frac{I}{r^2}$

73. Nëse shtresat e lëngut gjatë lëvizjes në gyp depërtojnë në njëra-tjetrën, (shih fig.) atëherë rrjedhja e lëngut është:

- A. laminare
- B. stacionare
- C. jo stacionare
- D. turbulente



74. Çka do të ndodhë me rrezet e dritës, nëse ato bien nga ajri në ujë? (shih.fig.)

- A. Rrezet e dritës do të thyhen
- B. Rrezet e dritës do të reflektohen
- C. Një pjesë e rrezeve të dritës do të reflektohet ndërsa pjesa tjetër e rrezeve do të thyhet
- D. Një pjesë e rrezeve të dritës do të reflektohet ndërsa pjesa tjetër e rrezeve do të difraktojnë



75. Është dhënë barazimi i reaksionit të djegies me flakë të metanit, me ç' rast përfitohet dioksidi i karbonit dhe avulli i ujit:



Në cilin rast është shënuar në mënyrë të saktë lloji i substancës, lloji i ndryshimit dhe lloji i produktit që përfitohet?

	<i>Metani (CH<sub>4</sub>)</i>	<i>Djegia</i>	<i>Dioksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>) dhe avulli i ujit (H<sub>2</sub>O)</i>
I	Element kimik	Ndryshim fizik	Elemente kimike
II	Element kimik	Ndryshim kimik	Komponime kimike
III	Komponim kimik	Ndryshim fizik	Elemente kimike
IV	Komponim kimik	Ndryshim kimik	Komponime kimike

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

76. Në një tretësirë të tejngopur të kripës së gjellës janë formuar kristalet e kësaj kripe. Si bëhet ndarja e kristaleve nga përzjerja, me metodën e filtrimit?


- A. Duke e përzier tretësirën vullshëm me ndihmën e shkopit të qelqit
- B. Duke e përshkuar tretësirën përmes letrës filtruese të vendosur mbi hinkë
- C. Duke e ngrohur tretësirën me flakëdhënës përmes rrjetës së azbestit
- D. Duke e ngrohur tretësirën me nxehtë elektrike përmes rrjetës së azbestit

77. Në cilin rast është dhënë barazimi i saktë?

- A. 1 mol O<sub>2</sub> = 6,022 x 10<sup>23</sup> molekula O<sub>2</sub>
- B. 1 mol O<sub>2</sub> = 16 atome O
- C. 1 mol O<sub>2</sub> = 32 molekula O<sub>2</sub>
- D. 1 mol O<sub>2</sub> = 6,022 x 10<sup>23</sup> atome O

78. Cili prej elementeve të dhëna në tabelë tregon afinitet elektronik (Ea) më të lartë?

- A. Litiumi (Li)
- B. Kromi (Cr)
- C. Karboni (C)
- D. Fluori (F)




79. Si duhet vepruar për të përgatitur 1 dm<sup>3</sup> tretësirë të hidroksidit të natriumit me përqendrim  $c = 0,1 \text{ mol dm}^{-1}$ ?

$$M(\text{NaOH}) = 23 + 16 + 1 = 40 \text{ g mol}^{-1}$$


- A. 4g NaCl duhet të treten në ujë dhe të hollohen deri në 1 dm<sup>3</sup>
- B. 4g NaCl duhet të treten në ujë dhe të hollohen deri në 100 cm<sup>3</sup>
- C. 2,3g NaCl duhet të treten në ujë dhe të hollohen deri në 1 dm<sup>3</sup>
- D. 1,6g NaCl duhet të treten në ujë dhe të hollohen deri në 100 cm<sup>3</sup>

$$c = \frac{n}{V} = \frac{m}{M \cdot V}$$




80. Në cilin rast është dhënë emri i saktë sipas nomenklaturës IUPAC për komponimin e dhënë?

- A. Etil-4-metil-2-heksen-5
- B. Metil-2-etil-4-heksen-5
- C. Etil-3-metil-5-heksen-1
- D. Metil-2-etil-3-heksen-1



81. Është dhënë barazimi i reaksionit të përfundimit të aldehideve nga alkoole:



Si duhet vepruar për të sintetizuar aldehidin acetik në laborator?

- A. Alkooli metilik duhet të oksidohet në prani të katalizatorit
- B. Alkooli etilik duhet të oksidohet në prani të katalizatorit
- C. Alkooli metilik duhet të reduktohet në prani të katalizatorit
- D. Alkooli etilik duhet të reduktohet në prani të katalizatorit


82. Për një komponim organik i cili përmban karbon, hidrogjen dhe oksigjen janë zhvilluar reaksionet karakteristike (me natrium, me tretësirë të Fehlingut dhe me fenilhidrazinë). Rezultatet janë paraqitur në skemën vijuese:

Në cilin grup bën pjesë komponimi i analizuar?

- A. Në alkoole
- B. Në fenole
- C. Në aldehide
- D. Në ketone

83. Si quhet ndryshe Vitamina A?

- A. Acid oksalik
- B. Acid oskorbik
- C. Retinol
- D. Tokoferol




**84.** Vërtetimi i pranisë së glycinës bëhet me reaksion të kompleksimit. Në një provëz vendoset tretësira e glycinës.

Çfarë reagjenti duhet shtuar në provëzën me tretësirë për të vërtetuar praninë e glycinës?

- A. Oksidi kupror (CuO)
- B. Oksidi feror (FeO)
- C. Kloruri kuprik (CuCl<sub>2</sub>)
- D. Kloruri ferik (FeCl<sub>3</sub>)

**85.** Një enë mbushet me ujë të pastër dhe në të zhyten dy elektroda, të cilat përmes qarkut elektrik lidhen për polet e baterisë. Në qarkun elektrik vendoset një llampë ndriçuese, si në figurën e mëposhtme. Në cilin rast llampa do të ndriçojë?


- A. Kur në enë shtojmë disa pika alkool
- B. Kur në enë shtojmë pakëz sheqer
- C. Kur në enë shtojmë pakëz amidon
- D. Kur në enë shtojmë pakëz klorur natriumi



**86.** Si quhet ndryshimi gjatë të cilit substanca ndryshon formën dhe përbërjen e saj?

- A. ndryshim fizik
- B. ndryshim kimik
- C. ndryshim mekanik
- D. ndryshim termik

**87.** Është dhënë formula strukturore e D-laktozës:



Në cilin rast është analizuar struktura dhe vetitë e saj dhe është dhënë përfundimi i drejtë për këtë sheqer?

	<i>Njësitë përbërëse</i>	<i>Vetitë kimike</i>	<i>Lloji i sheqerit</i>
I	Dy njësi glukoze	Reagon me tretësirë Tollensi	Disakarid joreduktues
II	Dy njësi glukoze	Nuk reagon me tretësirë Tollensi	Disakarid reduktues
III	Një njësi galaktoze dhe një njësi glukoze	Reagon me tretësirë Fehlingu	Disakarid reduktues
IV	Një njësi glukoze dhe një njësi fruktoze	Nuk reagon me tretësirë Fehlingu	Disakarid joreduktues

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

## BIOLOGJI

**88.** Procesi i sintezës së glukogjenit nga substancat që nuk bëjnë pjesë në sheqerna ka të bëjë me:

- A. glukolizën
- B. glukogjenolizën
- C. glukogjenezën
- D. glukoneogjenezën

**89.** Organizmat të cilët nuk u adaptohen ndryshimeve të mëdha të faktorëve ekologjikë janë organizma:

- A. homeotermë
- B. poikilotermë
- C. stenovalentë
- D. eurivalentë


**90.** Njohja e aftësisë së notimit të shpejtë të delfinët ka gjetur mjaft zbatim. Në bazë të këtij ndërtimi janë konstruktuar:

- A. torpedot
- B. eholokatorët
- C. helikopterët
- D. radarët

**91.** Gjymtyra e përparme e luanit dhe e picërrakut paraqesin:

- A. organe analoge
- B. organe homologe
- C. organe rudimentuese
- D. organe kaluese

**92.** Në bazë të të dhënave të paraqitura në diagram, ju duhet të gjeni se për cilin organizëm është fjala:



- A. peshkaqeni
- B. lakuriqi
- C. balena
- D. krokodili

**93.** Transkriptimi është proces përmes të cilit:


- A. ADN-ja sintetizon ARN
- B. ARN-ja sintetizon proteina
- C. ADN-ja rikrijon vetveten
- D. ARN-ja rikrijon vetveten

**94.** Cila gjëndër endokrine lidhet përmes shigjetës me prodhimin e saj të vërtetë që kryen?

- A. gjëndra tiroide → prodhimi i glukagonit
- B. gjëndra paratiroide → prodhimi i adrenalines
- C. pankreasi endokrin → prodhimi i glukagonit
- D. gjëndra mbiveshkore → prodhimi i melatoninës

95. Në figurë shihet zhvillimi i fluturës. Nga kjo figurë mund të konkludojmë për

- A. metamorfozë jo të plotë
- B. zhvillim pa metamorfozë
- C. zhvillim me partenogjenezë
- D. metamorfozë të plotë



96. Në fotografi shihen deveja, gjirafa, dreri. Në cilin grup të shtazëve bëjnë pjesë këta organizma:



deveja



dreri



gjirafa

- A. Brejtës
- B. Strajcorë
- C. Thundrorë
- D. Krahëlëkurorë

97. Gametet mashkullore te algat e kuqe (Rhodophyta) krijohen në:

- A. vezore
- B. anterid
- C. karpogon
- D. arkegon

98. Sa i përket shkallës së organizimit qelizorë, virusët njihen si organizma:

- A. joqelizorë
- B. kolonial
- C. njëqelizorë
- D. shumëqelizorë

99. Bashkësia e të gjitha veçorive të një organizmi shënohet si :

- A. kariotip
- B. mutacion
- C. fenotip
- D. gjenotip

100. Qendra nervore e të folurit te njeriu është e vendosur në:

- A. trurin e ndërmjeshëm
- B. trurin e vogël
- C. palcën e zgjatur
- D. trurin e madh